

SHPLLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i vendit të punës:	Statisticient i ri
Grada e pozitës:	shtatë (7)
Kohëzgjatja e punësimit:	me afat të pacaktuar
Departamenti:	i Statistikës
Divizioni:	Statistikat Financiare
Raporton tek:	Udhëheqësi i Divizionit të Statistikave Financiare

Përshkrim i detyrave dhe përgjegjësi:

- Zbaton programin e punës të Departamentit të Statistikës në pajtueshmëri me përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të Divizionit të Statistikave Financiare;
- Identifikon burimet kryesore të të dhënave për përpilimin e statistikave të llogarive financiare;
- Avancën kornizën raportuese për mbledhjen e të dhënave nga sektorët e nevojshëm institucional me qëllim të integritetit të tyre në statistikën e llogarive financiare.
- Mbledhë të dhënat statistikore dhe i kontrollon ato; integron statistikën nga sektori financiar dhe jo-financiar dhe përpilon statistikën e llogarive financiare në nivel vendi në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare;
- Përgatit statistikën për publikimet periodike dhe jo periodike në pajtueshmëri me politikën e publikimeve dhe me përvojat më të mira lidhur me shpërndarjen e informatave statistikore;
- Jep mendime dhe rekomandime lidhur me çështjet e ndryshme që kanë të bëjnë me mbledhjen, përpilimin, kontrollimin dhe publikimin e informatave statistikore;
- Propozon dhe merr pjesë në mënyrë aktive në hartimin e metodologjisë së përpilimit të statistikave, zhvillimin e procedurave të punës si dhe dokumenteve tjera administrative të Divizionit të Statistikave Financiare;
- Mbanë bashkëpunimin e nevojshëm me të gjitha palët për mbledhjen e informatave dhe çështjet tjera statistikore;
- Kryen punë të tjera sipas kërkesës së mbikëqyrësit.

Njohuritë e kërkuara:

- Nivel universitar në ekonomi, statistikë, financë, matematikë ose disiplinë të ngjashme. Niveli pasuniversitar është i dëshirueshëm;
- Njohuri e mirë në zbatimin e teknikave moderne statistikore;
- Të jetë i/e rrjedhshëm në gjuhën shqipe dhe/ose serbe;
- Gjuha angleze është e preferuar;
- Njohje e mirë e programeve kompjuterike;
- Aftësi të mira për të punuar i pavarur, si dhe për të qenë konstruktivë në punë ekipore, kur afatet kohore janë të ngushta dhe oraret janë të paplanifikuara;
- Të ketë vetiniciativë, aftësi të mira të komunikimit dhe koordinimit.

Përvoja e kërkuar:

- Përvoja e punës në statistikë ose disiplinë të ngjashme është e dëshirueshme.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **13 mars 2024**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org